



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Konferenca e Kryetarëve

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.01.2019 ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i kërkesës së një grupi prej më shumë se 35 deputetësh të opozitës për ngritjen e një komisioni hetimor.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektprogramit të punimeve për fillimin e sesionit të katërt të punimeve të Kuvendit.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektkalendarit 3 javor për fillimin e sesionit të katërt të punimeve të Kuvendit.
4. Miratimi i kalendarit të raportimeve vjetore të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Senida Mesi –	Zëvendëskryeministre
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Petrit Vasili -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
	Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Fatmir Mediu -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane
Genc Pollo -	Kryetar i Komisionit për Integrimin Europian
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Albana Vokshi -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Eduard Shalsi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Erion Braçe - Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja - Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Mimi Kodheli - Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme

HAPET MBLEHJA

Gramoz Ruçi – Mirëdita!

E thirra mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve për të shqyrtuar kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit “Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe institucioneve të tjera shtetërore për certifikatën e sigurisë të zotit Gent Cakaj, në zbatim të ligjit “Për administrimin dhe përpunimin e informacioneve”, pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument, në cilësinë e zëvendësministrit për Europën dhe Punët e Jashtme apo detyra të tjera shtetërore, kërkesë e bërë nga 35 deputetë të opozitës, sipas Rregullores dhe ligjit organik “Për komisionet hetimore”.

Detyrime të tjera të Konferencës së Kryetarëve janë: miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 21 janar-1 mars, i kalendarit 3-javor, 21 janar-8 shkurt, si dhe i kalendarit të raportimeve vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Fillojmë me pikën e parë.

Siç e thashë, nga 35 firmëtarë, deputetë të Partisë Demokratike dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim, është paraqitur një kërkesë, të cilën e keni përpara, për ngritjen e komisionit hetimor, në zbatim të ligjit.

Doja të dija se çfarë mendimesh ka nga të pranishmit.

Edmond Spaho – Faleminderit, zoti Kryetar!

Një grup prej 35 deputetësh të Partisë Demokratike dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim ka kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor për të shqyrtuar procedurën e pajisjes me

certifikatë sigurie të zëvendësministrit të Punëve të Jashtme, i propozuar për postin e ministrit të Punëve të Jashtme.

Sipas të gjitha fakteve që disponojmë, procedura e ndjekur është në kundërshtim me legjislacionin me të cilin operon drejtoria përkatëse në Kryeministri, pasi brenda 24 orëve është bërë kërkesa dhe zoti Gent Cakaj është pajisur me certifikatën e sigurisë, në një kohë kur janë një sërë institucionesh, brenda dhe jashtë vendit, që duhet të shprehen për këtë. Për më tepër, për këtë çështje është shprehur edhe Presidenti i Republikës. Një ndër argumentet, me të cilin Presidenti ka refuzuar ta dekretojë Gent Cakajn si ministër të Jashtëm, është edhe mënyra se si ai është pajisur me certifikatën e sigurisë.

Hollësitë e kemi paraqitur në kërkesën që ju ka ardhur, të cilën secili prej nesh e disponon. Kërkesa është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin “Për ngritjen e komisioneve hetimore”. Kështu që nuk besoj të ketë pengesa dhe do ta miratojmë ngritjen e tij menjëherë, në mënyrë që të fillojë nga puna, sepse kjo çështje është ende rendi i ditës në debatet e forcave politike dhe institucioneve. Do të ishte mirë, në interesin e institucioneve, por edhe të opinionit publik, që të jepej një përgjigje e plotë, e qartë dhe shteruese për këtë çështje.

Taulant Balla – Faleminderit, zoti Kryetar!

Së pari, dua të them shumë qartë se sa herë që opozita ka kërkuar komisione hetimore, qoftë në legjislaturën e kaluar, qoftë në këtë legjislaturë, gjithmonë ne kemi rënë dakord. Edhe në këtë rast jemi dakord në parim për ngritjen e një komisioni hetimor për rastin që referohet në kërkesë.

Sigurisht, Konferenca e Kryetarëve, e cila ka trashëguar kompetencat e Byrosë, të parashikuara në ligjin e vitit 2002 për komisionet hetimore, parashikon shumë qartë kompetencat e Konferencës së Kryetarëve në këtë këndvështrim, ku ne jemi të detyruar të shikojmë nëse kërkesa plotëson kriteret bazë, qofshin ato të numrit të deputetëve kërkuar firmëtarë, e cila është tërësisht në përputhje me ligjin, qoftë edhe për sa i përket një vlerësimi, që lidhet me këndvështrimet dhe leximet që mund të kemi për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për sa i përket objektit. Megjithatë, unë besoj që të gjitha këto plotësohen.

Siç kemi bërë në të gjitha rastet e tjera, deri në vendimin e seancës, ne si maxhorancë duam që të vijmë me ndonjë propozim pa prekur aspak thelbin e kërkesës së opozitës. Kam vetëm një nënvizim: te kërkesa juaj, konkretisht te ndarja e anëtarëve të komisionit, flisni për përfaqësues të grupeve të ndryshme parlamentare të maxhorancës. Në legjislaturën aktuale maxhoranca ka vetëm një grup parlamentar. Besoj se ky është lapsus i atyre që kanë shkruar kërkesën tuaj.

Pra, në parim, ajo që mbetet nga ato që thashë është që ne jemi dakord. Kini parasysh, e rëndësishme dhe që duhet të nënvizohet sot është që bëhet fjalë për një komision hetimor, që do të hetojë institucione, të cilat bëjnë pjesë në grupin e institucioneve që trajtojnë informacion të klasifikuar sekret shtetëror. Kështu që në projektvendim duhet të jemi shumë të qartë që edhe anëtarët e komisionit hetimor të jenë të pajisur me certifikatat përkatëse, të cilat duhet t'i plotësojnë brenda afateve, por edhe duhet të respektojmë të gjithë frymën e ligjit “Për informacionin e klasifikuar në Republikën e Shqipërisë” dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore, me qëllim që ne si institucioni themelor në Shqipëri, sepse jemi një republikë e pastër parlamentare, të jemi tërësisht në respekt të gjithë këtij kuadri ligjor.

Pra, në parim jemi dakord. Sipas ligjit për komisionet hetimore, ne jemi dakord që konferenca ta kalojë në seancë plenare dhe seanca plenare ta miratojë.

Edmond Spaho – Pra, nëse ju kuptova drejt, ju kërkon të bëni ndryshime në objektin e kërkesës sonë?

Kini parasysh që kjo është kërkesë jona për një çështje të caktuar dhe shumë të definuar: pajisja me certifikatën e sigurisë të zëvendësministrit dhe propozimit për ministër të Jashtëm. Si janë ndjekur rregullat, ligji dhe a ka pasur apo jo ndërhyrje apo presione nga institucione shtetërore. Bazuar në problematikën që do të rezultojë, do të mund ose jo të propozojmë ndryshime në rregullat përkatëse. Nëse ju dëshironi të ngrini komision hetimor për çështje që ju shqetësojnë ju, jeni të mirëpritur dhe ne e miratojmë me objektin që ju doni të shqyrtoni. Ky komision do të ngrihet sipas kërkesës sonë për çështjen që ne duam të hetojmë në përputhje me ligjin për komisionet hetimore. Nuk ka arsye pse të fillojmë historitë e vjetra. Ne kërkojmë të hetohet CEZ-i për një periudhë të caktuar kohe, kurse ju i shtoni objektit që ne kemi kërkuar edhe periudhën nga viti 2005, madje edhe më përpara. Këto praktika i kemi lënë pas, nuk ka arsye pse t'i rikthehemi dhe duhet miratuar objekti, ashtu siç e kemi kërkuar ne, që të plotësohet kërkesa e grupeve parlamentare të opozitës.

Sa i përket informacionit të klasifikuar, ne kemi rregulla për këto, komisioni hetimor do të funksionojë në përputhje me rregullat pa ceduar asnjë pikë në drejtim të informacionit të klasifikuar, të cilin duhet ta njohin vetëm njerëz të autorizuar për të trajtuar informacion të klasifikuar.

Edi Paloka – Faleminderit, zoti Ruçi!

Meqë jemi te komisionet hetimore, unë sot jam detyruar të depozitoj për herë të dytë kërkesën për shtyrjen e afatit të komisionit hetimor “Tahiri”. Kjo nuk është për të qeshur, por për të vënë duart në kokë, sepse arsyeja pse ky komision vazhdon të zvarritet dhe pse unë jam

i detyruar të bëj për herë të dytë kërkesën për shtyrjen e tij, është se dy institucionet, që janë pjesë kryesore e këtij hetimi, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, ende sot e kësaj dite që nga prilli i vitit të kaluar, kur ne kemi bërë kërkesën, ku u kemi kërkuar informacion dhe dokumentacionin e duhur, nuk kanë sjellë asnjë rresht, asnjë dokument në përgjigje të detyrimit që ata kanë për t'i dhënë informacion këtij komisioni hetimor.

Kjo është shumë e rëndë, sepse për ne qëllimi është i qartë, në fakt, e kemi shprehur dhe jemi të bindur se për çfarë shprehet kjo, por fakti që iku Xhafaj dhe erdhi Lleshaj e bën edhe më të fortë këtë bindje, sepse vërteton se nuk ka qenë thjesht qëndrimi i një ministri për arsye e tij, për lidhjet që ai kishte me drogën ose histori të tjera, por është qëndrim i qartë i Kryeministrit dhe i qeverisë së tij për të penguar hetimin e një çështjeje kaq të rëndësishme që, në fakt, sot është bërë publike dhe njihet botërisht jo vetëm nga shqiptarët, por edhe nga institucionet e tjera ndërkombëtare. Qëllimi është thjesht për të penguar zbardhjen e lidhjes së qeverisë “Rama” me krimin, me drogën dhe me të gjithë atë që ndodhi gjatë drejtimit të asaj ministrie nga Saimir Tahiri.

Ajo që mua më shqetëson më tepër është se në të njëjtën mënyrë e kemi ngritur këtë problem edhe në Konferencën e Kryetarëve dhe nuk ka pasur reagime as nga parlamenti. Kur një Llesh, Lleshi i Ramës në Ministri të Brendshme nuk do t'ia dijë për parlamentin, për çfarë parlamenti flasim ne? Ky parlament prej kohësh është jashtë të gjitha funksioneve të tij, por ky është vetëm një rast më tepër që tregon se sa vlerë ka ky parlament.

Këtë e ngrita për t'ju vënë në dijeni ju si Kryetar parlamenti, që të dini si ju trajtojnë nga Xhafaj te Lleshi dhe drejtori i policisë që është aty. Sigurisht, me ta ne do të merremi edhe me formë tjetër, sepse pengimi i hetimeve nuk është vetëm një shkelje e ligjit për komisionet hetimore, por është edhe shkelje e Kodit Penal, është vepër penale.

Faleminderit!

Taulant Balla - Mendoj që, së pari, ta mbyllim çështjen e parë, atë që është parashtruar nga një grup prej më shumë se 35 deputetësh, dhe që unë dua ta theksoj se jemi dakord në parim.

Së dyti, ky është një diskutim që në Kuvendin e Shqipërisë bëhet prej 16 vjetësh dhe Gjykata Kushtetuese e ka sanksionuar qartë të drejtën e njërës palë kur propozohet nga shumica (rastet janë të pakta, tri komisione hetimore gjithsej në të gjithë historinë 16-vjeçare kanë qenë propozime të shumicës, pjesa tjetër gjithmonë janë të opozitës), pra të drejtën e palës tjetër, të shumicës, për të bërë propozime, por pa prekur asnjëherë thelbin e hetimit dhe kjo është garanci që jua ka dhënë Gjykata Kushtetuese dhe kjo nuk preket aspak. Unë ju thashë disa elemente të pasurimit të vendimit që kemi përpara. Kur Kuvendi të shprehet me vendim,

këto elemente të respektimit të ligjit, të informacionit të klasifikuar, të transpozimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të jenë pjesë, në mënyrë që të mos lindin më pas probleme në punën e komisionit hetimor.

Një pjesë nga ju nuk kanë qenë anëtarë të komisioneve hetimore, por ju e dini që sapo mbledhet komisioni hetimor përplasja e parë që lind shpeshherë mes maxhorancës dhe opozitës, gjithmonë në komisionet hetimore, është objekti, pavarësisht se objektin e përcakton me vendim Kuvendi. Planin i hetimit dhe të gjitha këto ne duhet t'i tejkalojmë ose t'i përfshijmë qartë në gjuhën e përdorur në vendim me qëllim që ky komision të jetë një komision i cili ta mbarojë punën e vet. Këtu mendoj se quhet i ezauruar diskutimi sa kohë që nga maxhoranca keni dakordësinë që ky komision të ngrihet. Ne kemi kohë në dispozicion që deri në shqyrtimin në seancë normale parlamentare të sjellim edhe propozimet për t'u reflektuar në këtë frymë që thamë, edhe ekspertët dhe specialistët e Kuvendit të reflektojnë këto që u diskutuan këtu dhe sigurisht të sjellin në të njëjtën ditë edhe emrat e anëtarëve të komisionit, me qëllim që komisioni të fillojë menjëherë nga puna. Mirë do të ishte që anëtarët e të gjitha grupet parlamentare të ishin të pajisur me certifikata sigurie me qëllim që të mos vonohemi aspak në këtë kontekst, por besoj se kjo është një gjë tashmë e tejkaluar.

Për pikën e dytë që u referua këtu, më falni, por propozimet për zgjatjen e afateve të komisioneve hetimore bëhen me shkrim dhe depozitohen në sekretarinë e Kuvendit brenda afatit të përfundimit të komisionit hetimor. Ju e dini që, nëse kjo nuk bëhet deri në afatin e përfundimit të komisionit hetimor, komisioni quhet i shpërndarë dhe për rrjedhojë duhet të ngrihet një komision tjetër hetimor me atë objekt. Këtë e dimë të gjithë këtu, megjithatë të mos jetë kjo përgjigjja përfundimtare, por, ju lutem, të mësohemi me kulturën minimale juridike të depozitimit të një kërkesë dhe të shprehemi mbi bazën e një kërkesë me firmë, që të kemi një dokument përpara. Nuk mund të diskutojmë apriori për çështje që nuk kemi asnjë informacion ose një kërkesë paraprake.

Kështu që, zoti Spaho, Konferenca e Kryetarëve e quan të ezauruar, sepse, kur të dyja palët janë dakord, për çfarë do të diskutojmë më tej? Pjesën tjetër të diskutimit e vazhdojmë në seancë plenare. Unë i kam gati emrat për anëtarë të komisionit, besoj i keni edhe ju dhe të ecim përpara.

Edmond Spaho- Për pikën e parë nuk kam çfarë të shtoj, pasi i thashë qëndrimet e propozuesve të kërkesës.

Në lidhje me pikën e dytë, dëshiroj t'i kujtoj zotit Balla që nuk po diskutojmë për anën formale, procedurale, por po diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme, mosfunksionimin e komisionit hetimor. Nuk bëhet fjalë që komisioni ka pasur kohë në

dispozicion, nuk ka arritur të mbyllë hetimin në kohë dhe i kanë kaluar afatet, nuk ka bërë kërkesën, por bëhet fjalë që komisioni nuk ka mundur të ushtrojë prerogativat e tij, sepse dy institucione shtetërore nuk i japin informacion. Nuk është hera e parë që veprojmë kështu. Këtë argument e kemi ngritur edhe një herë tjetër kur zgjatëm afatin e komisionit hetimor, na u premtua që do të merren masa dhe i gjithë informacioni që kërkoi komisioni do të vihet në dispozicion. Për fat të keq kaloi edhe afati i dytë që i kemi vënë në dispozicion komisionit dhe informacioni nga këto dy institucione ende nuk ka ardhur. Unë dëshiroj të sjell në vëmendjen e Kryetarit të Kuvendit se është përgjegjësia e tij të garantojë që komisioni hetimor kuvendor të ketë informacionin nga institucionet shtetërore. Garanti është Kryetari i Kuvendit dhe ai duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm ligjorë që t'i sigurojë informacionin e nevojshëm komisionit hetimor. Madje është përgjegjësia e Kryetarit të Kuvendit që këto institucione t'i dërgojë për ndjekje penale, sepse kanë shkelur ligjin sa kohë që institucionet nuk respektojnë Kushtetutën, nuk respektojnë ligjin për komisionin hetimor.

Pra, të mos e kthejmë debatin në çështje të karakterit formal, sepse kjo është një çështje përmbajtësore thelbësore.

Gramoz Ruçi – Nuk ka?

Atëherë, jemi dakord që kërkesa i plotëson kushtet e kërkuara nga ligji lidhur me 36 firmat? Sipas nenit 77, pika 2 e Kushtetutës dhe të nenit 25 të Rregullores, si dhe sipas nenit 6 i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit dhe që po shqyrtohet sot brenda afatit 5-ditor. Ashtu sikurse e përmban qëllimin apo objektin që po diskutohet këtu, në qoftë se keni nevojë për t'u konsultuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese apo me ligjin pa cenuar të drejtën e nismëtarëve për ngritjen e komisionit hetimor, konsultohuni, zoti Spaho dhe zoti Balla, para seancës plenare, kur kjo të përfshihet në rendin e ditës.

Kërkesa përmban edhe çështje të tjera sipas ligjit, ashtu sikurse edhe përbërjen e komisionit me 9 veta, 5 nga maxhoranca dhe 4 nga opozita. Kryetari i komisionit, sigurisht u përket nismëtarëve, nënkryetari i përket maxhorancës, edhe kjo në përputhje me nenin 9 të ligjit, si dhe afatin e saj që është 3-mujor. A jeni dakord me këtë?

Vazhdojmë me çështjen tjetër, draft-programi dhe draft-kalendari i punimeve të Kuvendit.

Taulant Balla – Ne jemi dakord me draft-programin dhe draft-kalendarin e paraqitur, i cili i ka mbartur të gjitha ligjet që nuk arritën të shqyrtoheshin në sesionin e kaluar. Nisur edhe nga Konferenca e Kryetarëve, shpresoj që edhe opozita të jetë në punën e përditshme parlamentare, edhe për të përfunduar që në seancën e parë ose atë pasardhëse të këtij sesioni të ri parlamentar të gjithë reformën zgjedhore me të cilën kemi ecur dhe partnerët tanë të

Bashkimit European mezi presin që të gjithë së bashku ta miratojmë me qëllimin që ajo të jetë kuadri rregullator i abdejtuar me të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet e 30 qershorit.

Sikurse kam bërë edhe në mbledhjen e vitit të shkuar të Konferencës së Kryetarëve, dua t'i them kolegut Spaho që edhe në seancën e parë të parlamentit për këtë vit do të kërkoja të tejkalojmë dhe të gjejmë gjuhën e përbashkët për çështjet e mbetura ende pezull, nëse ju mendoni që ka ende çështje të mbetura pezull, me qëllim që t'i miratojmë.

Mbaj mend që në seancën e fundit të Konferencës së Kryetarëve të vitit të kaluar ju keni thënë se nuk ishit të përgatitur për këtë çështje dhe ju mirëkuptoj tërësisht. Unë besoj se tashmë, edhe me rritjen e ndjeshmërive dhe të interesit të Bashkimit European apo të vendeve të tjera për këtë çështje, le të themi anëtare, këtu kujtoj Gjermaninë, do të ishte mirë që ne ta konkludonim reformën zgjedhore në kohë për t'u lënë kohë institucioneve, kryesisht KQZ-së apo institucioneve të tjera. Janë shumë ndryshime, të cilat kanë rritur transparencën e procesit zgjedhor, kanë rritur kontrollin ndaj financave të partive, kanë hequr historitë e financimeve dhe ju i dini se çfarë rregullimesh kemi bërë, me qëllim që të garantojmë një proces sa më të barabartë dhe sa më transparent zgjedhor.

Gramoz Ruçi – Kush e do fjalën?

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Sa i takon reformës zgjedhore nëse ka palë të interesuar, ajo është opozita. Që nga momenti që është ngritur komisioni bipartizan për reformën zgjedhore opozita ka qenë thellësisht e interesuar dhe ka dhënë të gjitha kontributet e saj, në mënyrë që kjo reformë të marrë formën e dëshiruar dhe të miratohet sa më parë dhe ky objektiv vazhdon e mbetet i pandryshuar për opozitën.

Por, sikurse e them këtë, dëshiroj të evidentoj edhe një herë, pasi e kemi thënë edhe në mbledhjen e fundit të Konferencës së Kryetarëve, edhe në raste të tjera, ku kemi diskutuar çështje të reformës zgjedhore, është e pamjaftueshme që ne të ngelemi vetëm thjesht në rregullime mekanike të Kodit Zgjedhor dhe të lëmë pas dore fenomene shumë të rëndësishme, të cilat i kemi evidentuar gjatë proceseve zgjedhore dhe duam që të mos na përsëriten në zgjedhjen e ardhshme vendore që i kemi në muajin qershor.

Për se e kam fjalën? Fjalën e kam për shumë detyrime, të cilat janë detyrime të qeverisë, të ekzekutivit dhe që nuk po marrin rrugëzgjidhje, që janë shqetësimi kryesor i opozitës, madje më shumë se sa rregullimet në Kodin Zgjedhor. Për shembull, çështja e skandencës së kartave të identitetit. Janë 1,4 milionë zgjedhës, të cilët në qershor do të jenë pa karta identiteti. Me infrastrukturën që kemi sot dhe me çmimet që janë aktualisht për kartat e

identitetit zgjedhësit e kanë të vështirë, për të mos thënë të pamundur të mund të pajisen në kohë.

Së dyti, është regjistri i adresave. Regjistri i adresave ende është i papërfunduar dhe i lejon transferime personash, sikurse ka ndodhur në të shkuarën, në vitin 2015, në zgjedhjet vendore, kur kryetari i bashkisë së Durrësit, për shembull, apo ish-kryetari i bashkisë së Kavajës, transferoi zgjedhës nga zona të tjera të bashkitë ku rezultati zgjedhor supozohej se do të ishte i ngushtë. Mos më thoni që kjo nuk është vërtetuar, sepse është vërtetuar katërçipërisht. Madje Kryeministri në vitin 2015 ka dalë dhe ka thënë: “Po nuk fitova më shumë se 2800 vota nuk do ta pranoj Bashkinë e Durrësit”.

Së treti, është votimi dhe numërimi elektronik. Për fat të keq në buxhetin e vitit 2019, megjithëse është kërkuar, nuk janë parashikuar fonde për projektin pilot që duhet të realizohet në dy qarqe të vendit para se ai të shtrihet në zgjedhjet e përgjithshme në gjithë territorin e Republikës. Ka fenomene të tjera, të cilat duhet të adresohen nga qeveria, si ndalimi i përfshirjes së policisë në procesin zgjedhor. Dua t’ju kujtoj këtu thirrjen e Kryeministrit në vitin 2017, që i bëri policisë, për të lënë uniformën pas përfundimit të orarit zyrtar dhe për të dalë në fushatë zgjedhore për Partinë Socialiste, sikurse edhe përfshirjen e kontingjenteve kriminale në procesin zgjedhor. Kemi parë interceptime telefonike të drejtuesve tuaj të pushtetit vendor me kontingjentet e krimit, në mënyrë që të siguroheshin vota për kandidatët e Partisë Socialiste në zgjedhjet e përgjithshme që lamë pas. E kemi parë përfshirjen tuaj dhe për çështje të tilla nuk është ndërmarrë asnjë hap, madje në mënyrë cinike është konsideruar si komunikim i të zgjedhurve me zgjedhësit. Ne e dimë që zgjedhësit real në Shqipëri janë kontingjentet e krimit, por që të pranohet publikisht është për t’u habit.

Dje e pamë sesi zgjidhet administrata publike dhe sesi përdoret për nevojat që ka maxhoranca gjatë procesit zgjedhor. Të gjitha këto fenomene, që prekin procesin zgjedhor, janë shumë negative, prandaj duhet të adresohen dhe janë përgjegjësi e qeverisë. Përpara se të bëjmë thirrje për të miratuar Kodin Zgjedhor, duhet të adresojmë këto çështje thelbësore, për opozitën janë shumë të rëndësishme, të cilat duhet të ecin bashkërisht me Kodin Zgjedhor.

Taulant Balla – Për të mos u zgjatur shumë, dua të theksoj dy gjëra që të jemi korrekt.

E para, në funksion të gjithë kësaj që thoni dhe për shkak të të pasurit më shumë informacion për buxhetin e KQZ-së, unë ftoj Partinë Demokratike që të plotësojë dy vakancat në KQZ. Pra, janë dy anëtarë të KQZ-së, që i takojnë partisë më të madhe në opozitë, të cilët duhet të sillen sa më shpejt. Ne do të votojmë në seancën më të parë çdo kandidaturë që plotëson kriteret ligjore minimale, me qëllim që të ecim përpara, por edhe ju të keni më shumë informacion, pavarësisht që, për fat të mirë, KQZ-ja drejtohet nga opozita.

Dua t'ju informoj që kryetari i KQZ-së ka gjithmonë mirëkuptimin nga ana jonë edhe për çështje të tjera të infrastrukturës zgjedhore. Pra, ai mund të sjellë në Kuvend edhe kërkesën për të shtuar buxhetin.

Për sa i përket pilotimit në 200 qendra votimi, të të gjitha formave të ndryshme të votimit tërësor elektronik, të pjesshëm apo të numërimit elektronik, buxheti është i planifikuar në fondin e kontigjencës, me qëllim që sapo të vini ju dhe të miratojmë Kodin Zgjedhor edhe kjo çështje do të jetë e plotësuar.

Zoti Spaho, të lutem, sepse ju keni qenë kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë kur është shqyrtuar kontrata koncesionare për kartat e identitetit, unë dhe zoti Braçe, asokohe kemi kërkuar që vlefshmëria e kartave të identitetit të mos jetë 10-vjeçare, por 15-vjeçare. Argumenti ka qenë tërësisht teknik nga kompania që kohëzgjatja e tyre të jetë 10-vjeçare. Ato janë lëshuar në fund të vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009. Kontrata dhe ligji “Për kartat e identitetit në Republikën e Shqipërisë” parashikon ripërtëritjen e tyre çdo 10 vjet për shkak të ndryshimeve që personat pësojnë në pamjen e tyre dhe nuk mund të jenë të vlefshme për identifikim, prandaj Kuvendi i Shqipërisë e ka ratifikuar këtë marrëveshje koncesionare.

Të lutem, ku është faji ynë këtu që kartat e identitetit mbarojnë tani dhe se çmimi i kartave të identitetit është i njëjti me atë që është miratuar nga kontrata koncesionare? Po ju them që është hera e parë ku Kuvendi i Shqipërisë ka hyrë në detaje të kontratës për të certifikuar çmimin në ligj. Megjithatë jemi këtu, sepse qeverisja është në një proces vijues.

Erion Braçe – ...çmimi është i përcaktuar me ligj të Kuvendit dhe në rritje, nga 10 në 15 mijë lekë. Pra me 50% rritje i miratuar këtu në Kuvend.

Edmond Spaho – Për punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e dini qëndrimin tonë, sepse keni vepruar në mënyrë të njëanshme dhe në shkelje të Kushtetutës. Nëse keni ndryshuar qëndrim, uluni me njerëzit e opozitës që trajtojnë këto çështje dhe të gjejmë zgjidhjen. Mënyra se si vepruat dhe zgjidhja që keni dhënë është antikushtetuese dhe në kundërshtim me legjislacionin sipas të cilin funksionon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për këtë ju kemi sqaruar edhe në parim, edhe në detaje.

E theksoj edhe një herë, nëse keni ndërruar qëndrim, ejani të flisni me ekspertët e opozitës.

Në lidhje me çështjen që sapo ngrite, unë nuk po diskutoj nëse duhet ta kishim bërë 10 apo 15 vjet, sepse, edhe sikur ta kishim bërë 15 vjet vlefshmërinë, do të vinte një ditë që do të mbaronte afati, por po diskutoj infrastrukturën. Sot kemi shumë herë më pak infrastrukturë

sesa kishim në momentin që u shpërndanë kartat e identitetit. Me këtë infrastrukturë që kemi sot nuk arrihet të zëvendësohen 1,4 milionë karta identiteti. Ky është shqetësimi ynë, së pari.

Së dyti, është edhe shqetësimi i çmimit, sepse sot jemi në një gjendje më të vështirë ekonomike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë po them. Sot jemi në kushte më të vështira dhe duhet të gjendet një zgjidhje, sepse njerëzit nuk kanë lekë të sigurojnë bukën e gojës dhe jo më të shpenzojnë për kartën e identitetit. Këto janë çështje që i zgjidh qeveria. Ashtu siç vepruam ne në vitin 2009, kur hapëm pika pa fund në çdo komunë për pajisjen e qytetarëve me karta identiteti dhe sikurse subvencionuan në atë kohë çmimin e kartës për shtresat në nevojë, duhet vepruar edhe sot në të njëjtën mënyrë. Pra referojuni praktikave që kemi ndjekur ne në atë periudhë.

Fatmir Mediu – Zoti Kryetar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në atë drejtim dua të shkoj, paraqitja e njëanshme e draftit nga ana e Partisë Socialiste bie ndesh me frymën e marrëveshjes për Komisionin e Reformës Zgjedhore. Pra, mendoj që të gjitha ato që ka parashtruar Partia Socialiste kanë vetëm një rrugë për t'u diskutuar, së bashku me draftet e tjera që janë në komisionin e posaçëm të analizohen, të shqyrtohen nga niveli i ekspertëve dhe pastaj në vendimmarrjen politike. Kjo është rruga më e drejtë që duhet ndjekur.

E dyta, është çështja e afatit të Komisionit të Reformës Zgjedhore. Mendoj që është e domosdoshme të mos vendosim afate tri apo gjashtëmujore për veprimtarinë e punës së këtij komisioni. Pra, afati i punës së Komisionit të Reformës Zgjedhore të jetë deri në mbyllje të reformës zgjedhore dhe të mos hyjmë në të njëjtin qerfull diskutimesh debatesh, u mbarua, nuk u mbarua dhe të tjera me radhë, sepse nuk kemi vetëm zgjedhje lokale, por kemi edhe zgjedhje të përgjithshme përpara.

Për sa i përket çështjes që shtroi me të drejtë zoti Spaho, kjo ka të bëjë me mundësinë e qytetarëve shqiptarë për të shkuar në procesin e votimit. Pra, pajisja me karta identiteti dhe paraqitja e saj është e domosdoshme në procesin e votimit. Prandaj qeveria ka detyrimin për pajisjen e qytetarëve me karta identiteti, për të marrë në konsideratë të gjithë faktorët që kanë të bëjnë me këtë çështje në mënyrë që qytetarët përpara zgjedhjeve të jenë të pajisur me karta identiteti. Nëse kjo situatë nuk do të konsiderohet, atëherë do të krijohet një kolaps shumë i madh parazgjedhor.

Nëse ulemi dhe analizojmë atë që tha edhe zoti Spaho, pra historikun e problematikave të tilla, pretendimin që keni ngritur ju në kohën kur keni qenë në opozitë, t'u referohemi atyre zgjidhjeve, në mënyrë që ne ta lëmë këtë debat mënjanë dhe të arrijmë të gjejmë gjuhën e

përbashkët, në mënyrë që të garantohet e drejta e qytetarëve për të votuar me kartë identiteti. Edhe një herë, kërkoj që Komisioni i Reformës Zgjedhore të funksionojë në bazë të atij vendimi të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe të mos ketë diskutime të njëanshme apo jotransparente. Pra, kërkoj që çdo mendim, çdo gjykim, çdo propozim i specialistëve ndërkombëtarë dhe vendas, apo edhe i partive politike të diskutohen në Komisionin e Reformës Zgjedhore. Mënyra se si po veprohet deri tani ka krijuar vetëm moskuptime dhe mosmarrëveshje në një kohë që zgjedhjet janë afër dhe ne jemi në një kolaps në raport me reformën zgjedhore.

Genc Pollo – Pjesërisht këtu u thanë ato që unë doja të thosha, por meqenëse në vitet 2008-2009 jam marrë me këtë çështje, mund të them se çmimi është pjesë e kontratës me kompaninë e-Aleat për lëshimin e pasaportave dhe letërnjoftimeve elektronike të miratohej në Kuvend me seriozitetin e duhur. Kështu, unë nuk e kuptova arsyen pse theksohet. Në fakt, çmimi është ai që është dhe përvoja e 10 vjetëve më parë e çoi qeverinë e asaj kohe të miratonte disa VKM, të cilat mundësonin rimbursimin ose nxjerrjen paraprake pa kosto dhe më vonë pagesën e të gjithë aplikantëve. Pra, operohej në kushtet e *citing note relativ*.

Ne nuk jemi në një *citing note* të ngjashëm, ka më shumë kohë, sepse skadenca e kartave është afërsisht nga pranvera, por përsëri mund të bëhet problem. E shikoj si diçka pozitive apelin që po bëjnë në medie nëpunësit e gjendjes civile për qytetarët që të nxjerrin letërnjoftimet e reja. Ndoshta kjo nuk do të ishte e mjaftueshme, sidomos në situatën ekonomike në të cilën ndodhemi dhe të jemi ndërgjegjshëm, dhe mekanizma të tillë rimbursimi duhet të konsiderohen nga qeveria. Në qoftë se për një arsye apo për një tjetër ndodh që një pjesë e mirë e qytetarëve me të drejtë votimi, nuk do të kenë letërnjoftime për të votuar, atëherë do të krijohet një problem për imazhin, reputacionin dhe besueshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është e rëndësishme për vetë zgjedhjet, kjo është e rëndësishme edhe për cilësinë e zgjedhjeve, që do të konsiderohen në vendime të tjera në nivel Europian. Kjo gjë nuk do të ishte e duhur, pasi do të kemi pasoja negative dhe do të detyrohemi që, me ligje të shpejta, të zgjasim vlefshmërinë e dokumenteve për përdorimin e identifikimit të zgjedhësve në qendrat e votimit, edhe pse data e letërnjoftimeve do të ketë skaduar. Kjo çështje mund të diskutohet, por që nuk zgjidhet këtu, sepse këtë çështje duhet pasur parasysh Këshilli i Ministrave.

Erion Braçe – Unë i pranoj të gjitha këto, natyrisht mbetet të verifikojmë masat që qenkan marrë në vitet 2008-2009 për këto kategori në nevojë e të tjerë me radhë.

Unë nuk e kuptoj, zoti Pollo, pse në vitin 2013 ju përcaktuat çmimin nga 2015 e në vijim? Pse ndryshuat kontratën në vitin 2013, për të vendosur një çmim prej 15 mijë lekësh, që

do të funksionojë gjithmonë në rritje, sepse në ndryshimin e kontratës, në vitin 2013, për kartat e identitetit kështu thuhet? Unë këtë nuk e kuptoj, megjithatë mendoj se ky është një problem që na takon të dyja palëve, pa asnjë diskutim i takon edhe shtetit për planet politike dhe partiake. Askush nuk mund të identifikojë në 1,4 milionë mbajtës të kartave të identitetit, që janë votuesit tuaj apo janë votuesit tanë apo që ne po penalizojmë votuesit tuaj dhe po favorizojmë votuesit tanë e të tjerë me radhë. Kjo është një histori, që nuk ka pse të kthehet as në politike, as në partiake për këtë gjë.

Në qoftë se ka precedentë të mëparshëm për të rimbursuar e të tjerë me radhë, atëherë le t'i shikojmë këta precedentë të mëparshëm, por ama nuk mund të thoni që sot gjendja është më e përqesuar. Po të rrisni çmimin me 50%, natyrisht që keq do t'i vijë kujtdo, sepse edhe mua po të më thuash që, nga 10 mijë lekë tani, do ta blesh me 15 mijë lekë, ë keq do të më vijë, aq më për më tepër për ata që banojnë në fshat apo për ata që janë me ndihmë ekonomike, siç thoni ju. Natyrisht, keq do t'u vijë të gjithëve. Por rritja e çmimit me 50%, me një ndryshim kontrate, nuk shkon. Ky është një diskutim që e kemi bërë në atë seancë, unë ju kërkoj ndjesë që e hapa këtu këtë çështje. Në atë diskutim ju kam thënë se do të vijmë në këtë ditë. Është e padrejtë që të rritet çmimi me 50% dhe merret vendimi në vitin 2013 për 2015-ën e në vijim, madje duke përcaktuar edhe koeficientët se si do të rritej ndër vite.

Genc Pollo – Unë nuk di të të jap një përgjigje, sepse këtë gjë e ka negociuar Ministria e Brendshme, por besoj se është bazuar në një metodologji kostoje. Unë di një gjë: e kam blerë kuponin te posta dhe ka kushtuar 15 mijë lekë të vjetër dhe po pres që të më vijë radha që ta nxjerr kartën time të identitetit. Pra, çmimi i kuponit për të nxjerrë një letërnjoftim të ri është 15 mijë lekë të vjetër. Kështu, ne duhet të orientohemi më tej dhe të zgjidhim problemet që mund të krijohen, të cilat nuk kanë të bëjnë me një parti apo me një tjetër, por me një nevojë që qeveria duhet ta zgjidhë.

Gramoz Ruçi – I gjithë problemi është që flasim ne nuk e dimë numrin e saktë se sa janë. Është një gjë e mirë, që ka filluar sensibilizimi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është 4 milionë.

Pra, gjëja e parë që unë bëra: pashë kartën time se kur skadonte. Kështu që është një gjë e mirë që ka filluar sensibilizimi i kësaj historie; është një gjë shumë e mirë angazhimi i Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për të ngritur të gjithë infrastrukturën për të shtuar numrin e sporteleve dhe për të punuar me orar të zgjatur. Ky

diskutim le t'i shërbejë këtij sensibiliteti, por edhe forcave politike për të angazhuar, në mënyrë që të mos kemi pengesa në këtë drejtim.

Ju lutem, a ka ndonjë problem për draftkalendarin dhe draftprogramin? Nuk ka.

Kam një pyetje: a ka ndonjë afat akti normativ, që është lënë në datën 24?

Mimoza Pano – Është propozuar për t'u bërë në seancën e parë, por afati mbaron në datën 2 shkurt 2019.

Gramoz Ruçi – Domethënë nuk ka afat. Pra, nuk kemi pse të bëjmë seancë, por t'u lemë kohë komisioneve atë javë. Ditën e hënë është seanca e hapjes së sesionit të ri dhe nuk kemi pse të bëjmë përsëri seancë ditën e enjte vetëm për aktin normativ, kështu që shtyhet për datën 31 janar.

A ka ndonjë vërejtje tjetër? Nuk ka.

A ka ndonjë vërejtje për kalendarin e raportimeve në Kuvend të organeve kushtetuese të krijuara me ligj?

(Diskutime pa mikrofon.)

Sigurisht, sot nuk jeni të përgatitur, por ju kujtoj se vitin e kaluar u bënë të gjitha raportimet, por asnjë raportim me debat. Kështu që është e drejta ekskluzive e grupeve parlamentare, në qoftë se do të kenë kërkesa për të zhvilluar debat për raportimet e institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj të depozitohen në kohën duhur. Këto ishin çështjet që kishim për sot.

Ju njoftoj se nesër kam bërë thirrje për një seancë të jashtëzakonshme plenare, me kërkesë të Kryeministrit, sipas Kushtetutës, duke pasur parasysh se plotësohet edhe afati 10-ditor që ka parlamenti për të shqyrtuar dekretet e Presidentit. Kështu, sipas nenit përkatës të Rregullores, kam nxjerrë urdhrin që kur ka kërkesë nga Presidenti i Republikës apo Kryeministri, Kryetari i Kuvendit përcakton rendin e ditës, datën dhe orën e mbledhjes. Pra, brenda 3 ditëve, siç e parashikon Rregullorja, i takon në nesër në orën 17:00, të gjithë kryetarët e grupeve janë të lutur të njoftojnë deputetët, pavarësisht se ata do të njoftohen në mënyrë zyrtare. Seanca plenare do të zhvillohet thjesht për të kaluar dekretet e Presidentit.

Faleminderit!

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Zoti Kryetar, unë mendova se çështja e mbledhjes së parlamentit nesër në një seancë të jashtëzakonshme do të ishte thashethem, madje kur nuk e përmendët edhe ju në rendin e ditës së Konferencës së Kryetarëve, mua m'u përforcua edhe më shumë ideja se ishte thashethem. Kuvendi mund të mbledhet në seancë të jashtëzakonshme, por duhet

të ketë arsye për t'u mbledhur. Është e vërtetë që në nenin 42 të Rregullores parashikohet që Presidenti, Kryeministri ose 1/5-ta e deputetëve kanë të drejtë të thërrasin deputetët në një seancë të jashtëzakonshme, por thirrja e një seance të jashtëzakonshme kërkon edhe një arsye të jashtëzakonshme.

Unë nuk mendoj se arsyeja për të cilën po e thërrisni ju, bie në atë kategori.

Nga ana formale, nëse do të kishim arsye, do të duhej që sot të kishim këtu kërkesën e Kryeministrit, motivimin e kërkesës, dhe kryetari të na njoftonte jo më pak se tre ditë përpara, sepse sot për nesër nuk më duket serioze. Kjo e shton edhe më shumë atë që ne pretendojmë, që ky Kuvend është jofunksional. Këtu shkelet Rregullorja sipas interesave të maxhorancës. Jo më kot, zoti Paloka e ngriti çështjen e mosfunksionimit të komisionit hetimor për kanabisin, për drogën. Tani po na jepni një shembull tjetër: që ju operoni, veproni në përputhje me nevojat tuaja. Nuk njihni as rregullore, as Kushtetutë, as ligj.

Kësisoj, unë nuk e shoh të udhës, nuk e shoh të arsyeshme, dhe nuk jemi dakord me thirrjen e seancës së jashtëzakonshme nesër. Nuk po hy pastaj në debate të tilla. Mund të kishin gjetur kohën e përshtatshme edhe për të bërë ndryshimet në qeveri, pasi ju e dini se me Kushtetutë, seanca, sezoni parlamentar fillon javën e tretë të janarit, të hënën e tretë të janarit.

Gjithashtu, meqenëse po e përdorni si argument dhjetëditëshin, dëshiroj t'ju kujtoj se ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, i cili thotë se Kuvendi mund ta kapërcejë afatin dhjetëditor, kur ka arsye. Me këtë dua të them se arsyeja juaj për të thirrur seancë të jashtëzakonshme nuk është e jashtëzakonshme. Së dyti, Kuvendi ka të drejtë, ia ka dhënë këtë të drejtë Gjykatës Kushtetuese, që ta kalojë afatin dhjetëditor, kur ka arsye. Arsyeja është se Kuvendi nuk është i mbledhur deri më datën 21 janar, dhe sot jemi më datën pesëmbëdhjetë, ditë e martë. Mund të prisni. Ne kemi pesë vjet pa qeveri, ndaj mund të prisni deri ditën e hënë, që të mblidhet Kuvendi.

Gramoz Ruçi – Ju lutem, në lidhje me këtë pikë...

(Deputeti Spaho flet pa mikrofon)

Zoti Spaho, të lutem!

Meqë m'u anatemua çështja e Rregullores, e moszbatimit, mosfunksionimit të Kuvendit... Sigurisht, është e drejta juaj të keni pikëpamjet tuaja në lidhje me këto çështje. Megjithatë, duhet të keni parasysh se, kur linçoni Kuvendin përfshini veten tuaj, dhe nuk është mirë që një kryetar grupi, një deputet të anatemojë vetveten, të anatemojë Kuvendin. Kuvendi nuk është i maxhorancës, por edhe i një deputeti të pavarur. Kësisoj, ju lutem të jemi seriozë. Unë nuk e kam problem për të shqyrtuar në kryesinë e Kuvendit, në qoftë se Rregullorja do të

thoshte këtë. Rregullorja thotë të kundërtën: Kuvendi thirret në sesion të jashtëzakonshëm pikërisht sepse data e mbledhjes së Kuvendit është data 21, sipas Kushtetutës. Prandaj quhet jashtë radhe ose jashtë sesioni ose e jashtëzakonshme; me kërkesë të motivuar të Presidentit, të Kryeministrit, ose të paktën e një të pestës së deputetëve. Dhe vazhdon: kryetari thërret mbledhjen e Kuvendit, nuk thotë kryesia, por kryetari, jo më vonë se tri ditë nga paraqitja e kërkesës. Jo më vonë se tri ditë.

Pra, kërkesa është bërë dje, sot jemi sot, nesër është seanca. Tri ditë. Rendi i ditës është thjesht votimi i dekreteve të Presidentit, kështu që s'ka gjë për të diskutuar këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cili është problemi?

Fatmir Mediu – Problemi është se nuk mund t'i mohojmë asnjë deputeti të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votimit pro ose kundër qeverisë. Për shkak të një thirrjeje kaq urgjente, mund të qëllojë që deputetët të jenë nëpër angazhime të ndryshme, të planifikuara më parë, duke e ditur se seanca do të jetë më datën 21.

Gramoz Ruçi – Të ndryshojmë Rregulloren pastaj? Çfarë të bëjmë, të ndryshojmë Rregulloren apo ta shkelim Rregulloren?

Edmond Spaho – Rregulloren ta zbatojmë.

Gramoz Ruçi – Si ta zbatojmë?

Edmond Spaho – Si thotë Rregullorja?

Gramoz Ruçi – Tri ditë.

Edmond Spaho – Kuvendi thirret në sesion të jashtëzakonshëm...

Gramoz Ruçi – Brenda tri ditësh.

Edmond Spaho – Me kërkesë të motivuar.

Tani dëshirojmë të shikojmë kërkesën me shkrim të Kryeministrit dhe motivimin. Kryeministri nuk mundet ta mbledhë Kuvendin për çdo kapriço të tij.

Gramoz Ruçi – S'është kapriço të miratosh dekretet e Presidentit.

Edmond Spaho – Kapriço mund të jetë.

Gramoz Ruçi – Kapriço për të miratuar dekretet e Presidentit?

Edmond Spaho – Me kërkesë të motivuar.

Gramoz Ruçi – Shumë e motivuar.

Edmond Spaho – Edhe për dekretet e Presidentit kemi një interpretim të Gjykatës Kushtetuese.

Gramoz Ruçi – Që?

Edmond Spaho – Që Kuvendi mund ta kapërcejë afatin dhjetëditor...

Gramoz Ruçi – Pse duhet ta kapërcejë? Pse?

Edmond Spaho – Sepse ke arsye.

Gramoz Ruçi – Çfarë arsyeje?

Edmond Spaho – S’e ke të mbledhur Kuvendin.

Gramoz Ruçi – Ja, po e mbledh.

Edmond Spaho – Po s’e ke të mbledhur.

Gramoz Ruçi – Do ta mbledh.

Edmond Spaho – Po s’ke të drejtë ta mbledhësh.

Gramoz Ruçi – Ah, s’kam të drejtë!

Edmond Spaho – Kushtetuta thotë: “Të hënën e tretë të janarit.”

Po shkel Kushtetutën!

Gramoz Ruçi – Përkundrazi, po e zbatoj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Urdhëro?

Albana Vokshi – Kërkesë të motivuar me shkrim, a keni?

Gramoz Ruçi – Po si s’kam!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush të tha se s’kam?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë thashë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Sille! Nxirre kërkesën! Ku e ke?

Gramoz Ruçi – Nxirre kërkesën, zonjë!

Edmond Spaho – Duhet të na e sjellësh ne, duhet të na e vësh në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Ku, në cilën rregullore?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në cilën rregullore?

Edmond Spaho – Po pse do të mblidhemi ne?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Sepse është bërë një kërkesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O Spaho, nuk e shtroj për diskutim. E shtroj për njoftim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Me leje, zoti kryetar!

Është në faqen e Kuvendit kjo kërkesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Kemi vepruar në rregull fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E para e punës, njëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Derisa e nxjerr në faqen e Kuvendit, duhet të ma japësh edhe mua këtu, në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ti nuk lexon dot në faqe të Kuvendit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Ju lutem, kërkesa është në faqen e Kuvendit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka motivimin përkatës, është konform Kushtetutës dhe sipas Rregullores, kështu që nesër në orën pesë, në seancë plenare.

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA